



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



09 Maj 2025

100 vite institucion, KLSH zhvillon leksion të hapur me studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës



Në vijim të aktiviteteve të 100-vjetorit të themelimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) zhvilloi në datë 9 maj 2025 një leksion të hapur me studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, duke sjellë më afër rolin e institucionit në forcimin e transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri. Leksioni me temë *“100 vite besueshmëri, integritet dhe shërbim ndaj qytetarëve – Kontrolli i Lartë i Shtetit si garant i transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri”* u mbajt nga audituesja e lartë, znj. Miranda Misini.

Znj. Misini prezantoi rolin historik dhe aktual të KLSH-së si një nga institucionet më të hershme të shtetit shqiptar dhe theksoi misionin e tij në mbështetje të shtetit ligjor, përmes forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.



Si mikpritëse e aktivitetit, Dekania e Fakultetit të Drejtësisë, Prof. Dr. Dorina Hoxha, falënderoi Kontrollin e Lartë të Shtetit për angazhimin në edukimin profesional të studentëve në këtë moment të rëndësishëm historik.



Nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet e arsimit të lartë dhe organizimit të takimeve me studentët, Kontrolli i Lartë i Shtetit synon të japë një kontribut të qenësishëm në formimin e brezave të rinj të profesionistëve.

Më 20 maj 2025, KLSH shënon 100 vite nga krijimi si institucioni më i lartë i kontrollit të financave publike në vend.



Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë



klsh@klsh.org.al



www.klsh.org.al